



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 26

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302

Prishtinë, më 9 mars 2016, në orën 11:00

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Flora Brovina, Njomza Emini, Fikrim Damka, Fadil Beka, Adem Hoxha dhe Hatim Baxhaku.

Munguan: Besa Baftiu, Time Kadrijaj, dhe Shukrije Bytyçi.

Pjesëmarrës të tjerë: Ukë Gashi-ZPRM, Osman Shatri dhe Rustem Gashi - HANDIKOS, Kaltrina Ahmeti – KDI dhe mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 15.02.2016;
3. Shqyrtimi i raportit të monitorimit buxhetor të skemave të ndihmës sociale;
4. Formimi i grupeve punuese për projektligjet në procedurë;
5. Të ndryshme.

Kryetarja e Komisionit, Flora Brovina, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 15.02.2016;

Kryetarja, konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, miratoi procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, më 15.02.2016, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit të monitorimit buxhetor të skemave të ndihmës sociale;

Kryetarja, tha se mund të vazhdojmë me shqyrtimin e Raportit të monitorimit buxhetor të skemave të asistencës sociale. Ky raport u përgatit nga grupi punues dhe u diskutua në mbledhjen e kaluar, janë përfshi propozimet nga mbledhja e kaluar dhe sot do ta votojmë për ta përcjell për miratim në Kuvend.

A keni ndonjë propozim shtesë.

Kryetarja konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, nxori këtë

Përfundim

Komisioni miraton raportin e monitorimit buxhetor të skemës së asistencës sociale

Kryetarja -Gjithashtu kemi edhe një raport hulumtimi për shëndetin oral, ky është një raport i mirë si për ne ashtu edhe për të interesuarit që merren me shëndetin oral, dhe është një çështje e mirë për Kuvendin e Kosovës që të aktualizoj tema që janë në shërbim të qytetarëve. Një ndër temat që duhet studiuar dhe duhet diskutuar propozoj të jetë edhe kujdesi parashkollor apo çerdhet sociale. Kjo është një temë që duhet ta aktualizojmë. Shumë qytetar që punojnë por kanë paga të ultë nuk mund ti paguajnë çerdhet prandaj duhet të diskutojmë për mundësin e ndërtimit të çerdheve sociale. Kjo çështje kërkon një bashkëpunim edhe me ministrin e punës dhe çështjeve sociale.

Ministri për punë dhe çështje sociale dje ishte në vizitë në Qendrën për rehabilitimin e nënës dhe fëmijës, e cila aktualizon çështjen e themelimit të çerdheve sociale. Një bazë ligjore për këto çerdhe nuk ekziston por duhet të ketë bashkëpunim edhe me ministrin e arsimit.

4. Formimi i grupeve punuese për projektligjet në procedurë

Kryetarja – Dy projektligjet, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe Projektligji për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkesve dhe punëdhënësve, kanë kaluar në lexim të par në Kuvend tani do të formojmë grupet punuese për amendamentim .

Kryetarja konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, nxori këtë

Përfundim

Formohet grupi punues për amendamentimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Kryesues i grupit punues do të jetë deputeti Fadil Beka, kurse anëtar të grupit punues do të jenë të gjithë anëtarët e komisionit.

Kryetarja konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, nxori këtë

Përfundim

Formohet grupi punues për amendamentimin e Projektligjit për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkesve dhe punëdhënësve. Kryesuese e grupit punues do të jetë deputetja Njomza Emini, kurse anëtar të grupit punues do të jenë të gjithë anëtarët e komisionit.

Kryetarja – Kemi një propozim për bashkëpunim nga KDI , të cilët ofrojnë bashkëpunim në realizimin e një hulumtimi për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

I falënderojmë për mbështetjen dhe bashkëpunimin dhe pajtohemi që tani kemi një hulumtim për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara por kërkojmë që mundësisht ta realizojnë edhe një hulumtim për çerdhet sociale.

Njomza Emini - Edhe më herët e kemi diskutuar që ta mbajmë një dëgjim publik për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Tani është një rast i mirë që ta mbajmë dëgjimin publik në bashkëpunim edhe me KDI, sepse të gjithë e dimë se ende nuk e kemi një numër të saktë të personave me aftësi të kufizuara . Nuk e dimë as numrin e saktë të atyre që punojnë edhe pse e kemi ligjin që atyre ju jap të drejtën të punojnë. Në disa raporte del se ka persona me aftësi të kufizuara që punojnë por ne nuk e kemi numrin e saktë. Në hulumtim është mirë të përfshihet edhe sa fëmijë me aftësi të kufizuara vijnë në mësimin.

Kryetarja – Për personat me aftësi të kufizuara kam edhe një lajm të mirë sepse në kuadër të veprimtarisë time humanitare, në bashkëpunim me koleget e mia në Dallas në shtator, shoqata humanitare në Dallas në bashkëpunim me një fabrikë do të sjell në Kosovë diku rreth 500 karroca për personat me aftësi të kufizuara. Këta karroca do të ndahen në bashkëpunim me Ministrin e Shëndetësisë dhe me shoqatat e personave me aftësi të kufizuara.

Adem Hoxha – Ju përshëndes të gjithëve. Pajtohem me kolegen që tha se duhet të punojmë në ngritjen e vetëdijes në meny që personat me aftësi të kufizuara mos të stigmatizohen sepse në Dragash familjet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara turpërohen. Ne duhet ta mbajmë dëgjimin publik dhe të diskutojmë se me çfarë problemesh përballen personat me aftësi të kufizuara. Përkrah propozimin e hulumtimit që të kemi një numër të saktë të personave me aftësi të kufizuara e sidomos sa i përket Komunës së Dragashit. Duhet tu dalim në ndihmë sa më shumë që të mundemi këtyre kategorive.

Kryetarja konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, nxori këtë

Përfundim

Kërkohet realizimi i dy hulumtimeve për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe një hulumtim për çerdhet sociale.

Gjithashtu të organizohet një dëgjim publik në bashkëpunim me KDI , për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

5. Të ndryshme.

Kryetarja – Në seancën e kaluar ishte e radhitur për aprovim një marrëveshje e Ministrisë së Shëndetësisë me Unicredit Bank Austria AG, e cila marrëveshje për një votë nuk u aprovua , sepse doli me disa probleme për ne të panjohura. Ne duhet të takohemi me Ministrin e Shëndetësisë dhe të diskutojmë ku është problemi dhe pastaj të veprojmë .

Njomza Emini - Pajtohem që të ftojme ministrin dhe të diskutojmë për këtë çështje.

Fikrim Damka – Duhet ta shqyrtojmë edhe specifikacionin në mënyrë të jemi më të informuar për hapat e mëtejme.

Kryetarja – Propozoj që me ministrin të diskutojmë edhe lidhur me Memorandumin e Mirëkuptimit midis Zyrës së Presidentit dhe Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me personat e dhunuar gjatë luftës. Të njoftohemi për format dhe mundësit e realizimit të këtij memorandumi, dhe si do të veprohet në këtë rast.

Njomza Emini – Kam edhe një çështje tjetër, kam pranuar shumë ankesa nga të punësuarit që nuk kanë kontrata pune të rregullta, si taksistët dhe shumë të tjerë . Kjo për mua është shumë alarmante, nuk duhet të ketë punëtor pa kontrata sepse nuk jemi në skllavëri ku njerëzit shfrytëzohen pa kontrata pune. Ndoshta duhet ta diskutojmë me inspektoratin që Ligji i punës të zbatohet më mirë.

Kryetarja – Ligji i punës ekziston , ekziston edhe marrëveshja kolektive por këto nuk po zbatohen . Ndoshta duhet të diskutojmë me KES se përse nuk po zbatohet Kontrata Kolektive.

Gjithashtu kërkojmë nga kryesuesi i grupit punues për amendamentimin e projektligjit për shërbimin mjekësor emergjent , deputeti Hatim Baxhaku të na njoftoj me punën e grupit punues për amendamentimin e këtij Projektligji.

Hatim Baxhaku – Grupi punues ka bërë një punë të mirë , edhe pse Projektligji ka pasur shumë mangësi. Kanë mbetur edhe disa nene për tu konkretizuar dhe për ta përfunduar amendamentimin. Presim edhe realizimin e një vizite jashtë vendit në mënyrë që me përvojën e fituar ta bëjmë një ligj sa më të mirë dhe ta bëjmë sa më funksional shërbimin mjekësor emergjent.

Fadil Beka – Këtë ligj e përcjellin disa mangësi qoftë buxhetore apo mangësi tjera sidomos sa i përket shërbimit paraspitalor emergjent.

Kryetarja – Ju falënderoj për kontributin dhe shpresojmë që ligji do të jetë i zbatueshëm me gjithë mangësitë buxhetore që e përcjellin këtë Projektligj.

Mbledhja përfundoi në orën 11:55.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Flora BROVINA